

nr. Prot 1.147

Data 12/09/2011



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**  
**MINISTRI**

OSHTYK

**URDHËR**

Nr. 83, Datë 9-9 2011

**PËR**

**CAKTIMIN E FUNKSIONIT TË KORDINIMIT TË SLOTEVE APO**  
**RREGULLIMIT TË ORARAVE NË AEROPORTE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 60 dhe 61 të Ligjit 10 040 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Funkcionet e kordinimit të slotëve apo të rregullimit të orareve në aeroporte do të kryhen nga stafi i Drejtorisë së Politikave të Transportit Ajror në Ministri e cila është struktura e vetme përgjegjëse për alokimin e slotëve apo rregullimin e orareve në aeroportet e Republikës së Shqipërisë.
2. Gjatë ushtrimit të këtij funksioni stafi përkatës duhet të veprojë në përputhje me rregullat transparente, asnjënjë dhe jodiskriminuese dhe ngarkohet të japë leje për të përdorur gamën e plotë të infrastrukturës aeroportuale, të nevojshme për të operuar një shërbim ajror, në një datë dhe kohë të caktuar, për qëllimin e uljes apo të ngritjes së avionëve.
3. Ngarkohen të gjithë subjektet operuese dhe rregullatore në fushën e aviacionit civil, për zbatimin e këtij urdhri
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare

**SOKOL OLLDASHI**

**MINISTËR**

